

Dita Botërore e Dhurimit Vullnetar të Gjakut

14 qershor

Dita Botërore e dhurimit vullnetar të gjakut është një ditë që i kushtohet ndërgjegjësimit të popullatës për të pasur sa më tepër dhurues vullnetarë të gjakut si dhe shpreh mirënjohjen për sakrificën që ata bëjnë. Kjo ditë mbahet çdo vit në 14 qershor, duke filluar nga viti 2004.

Gjaku, përveçse një përbërës i rëndësishëm i trupit tonë, është edhe një lëndë kuruese që nuk mund të prodhohet nga industria farmaceutike, ndaj i vetmi burim i tij është dhurimi i gjakut nga njerëzit vullnetmirë në mënyrë të herëpashershme dhe pa pagesë.

Nevojat për gjak janë shumë të mëdha pasi transfuzioni i gjakut apo përbërësve të tij, shërben shpesh për t'i shpëtuar jetën dikujt që pëson aksident (të çdo forme) apo ndërhyrje kirurgjikale të shoqëruar me hemorragji, por edhe si kurë shoqëruese në disa patologji si anemitë si talasemia, hemofilia, anemitë hemolitike, leucemitë, të transplantuarit, etj...

Më parë, pjesa më e madhe e gjakut në Shqipëri sigurohej nga dhënësit me pagesë, të cilët duke qënë njerëz nevojtarë, shpesh sëmureshin, duke dhënë kështu gjak jo të sigurtë për ata që kishin nevojë.

Aktualisht në sajë të informimit dhe promovimit të bërë nga institucionet shëndetësore dhe organizatat vullnetare, ajo sigurohet kryesisht nga familjarët dhe dhuruesit vullnetarë. Megjithatë ende në Shqipëri dhurohet 10 herë më pak gjak se sa janë nevojat për të.

Duhet të dini se gjaku ka një cikël riprodhimi të përhershëm prej 21 ditësh, pra është e zakonshme që ai të shkatërrohet vetë. Përse t'a lemë të shkojë dëm?!

Para se të kryeni këtë akt solidariteti, mjekët do të sigurohen se ju gëzoni shëndet të plotë dhe ky dhurim nuk do ta dëmtojë shëndetin tuaj. Kjo realizohet nëpërmjet intervistimit dhe vizitës mjekësore.

Pasi kryeni dhurimin, ju duhet të qëndroni disa minuta shtrirë dhe të pini të njëjtën sasi uji apo lëngjesh, për të zëvendësuar gjakun e dhuruar. Pas disa ditësh, për shkak të ciklit natyror të riprodhimit, gjaku do të rifitojë të njëjtin përqëndrim të përbërësve të vet.

Më tej gjaku juaj egzaminohet për disa sëmundje ngjitëse si: HIV, Hepatitet dhe Sifilizi, por edhe analizat e zakonshme si gjaku komplet dhe parametrat biokimike. Këto egzaminime janë shumë të rëndësishme si për shëndetin e dhuruesit dhe për atë të marrësit. Gjithnjë e më shumë janë përmirësuar teknikat laboratorike të analizimit, për të krijuar një siguri sa më të madhe të gjakut në bankat ku ruhet. Vetëm nëse edhe keto egzaminime rezultojnë brenda normave, atëherë gjaku

juaj kalon për përpunim dhe ndarje sipas nënprodukteve të vet dhe më tej i jepet për transfuzion të sëmurit.

Gjak mund të dhurojnë të gjithë ata që janë të shëndetshëm dhe kanë moshë nga 17 vjeç (me lejen e prindit)/ 18 deri 65 vjeç dhe peshë minimale 50 kg. Dhurohet 450 ml($\pm$ 10%) dhe kjo këshillohet të bëhet 4 herë në vit për burrat dhe 2 herë në vit për gratë në moshë pjellorie.

Vëndi ku ju mund t'a dhuroni gjakun tuaj janë te gjitha Bankat e gjakut pranë spitaleve në çdo qytet, Qendra Kombëtare e Dhurimit të gjakut në Laprakë dhe çdo Institucion shtetëror, fetar apo privat që ofrohet të kthehet në qendër të përkohshme të dhurimit vullnetar të gjakut.

Në këtë mënyrë ju keni kryer një akt heroik, pra i keni shpëtuar jetën dikujt apo keni ndihmuar dikë tjetër që të jetojë më gjatë dhe më mirë.

Organizmat që merren me sensibilizimin dhe promovimin e dhurimit vullnetar të gjakut janë Degët e promocionit shëndetësor pranë Drejtorive të Shëndetit Publik në rrethe, Organizata e Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut dhe Kryqi i Kuq.

Të dhurosh gjak është një akt solidariteti human që shpëton jetën e njerëzve në nevojë. Ajo është dhurata më e çmuar që ne mund t'i bejmë një njeriu tjetër që ka nevojë. Ajo është dhurata e jetës.